



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br. 210/22

Nr. i Tq. / Br. sh. -1-

Data / Datum 06.09.2022

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 15 të Ligjit Nr. 08/L-066 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, në lidhje me Nenin 30.1, 30.5 shkronja “c” të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe nenin 12 paragrafi 2 shkronja “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 41 paragrafi 2 shkronja “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datë 6 shtator 2022 merr këtë:

VENDIM

PËR TRANSFERIN E MJETEVE FINANCIARE TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim bëhet transferimi i mjeteve financiare në vlerë 10,003.00€, të cilat transferohen nga programi Arsimi (93690), Projekti “Ndërtimi i shkollës në Gllavatin” me Kod 52191, në programin Planifikimi urban (66425) në projektin “Asfaltimi i rr. Vesekoc – Sllakoc” me Kod 52188.
2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi mbeten në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale dhe në kuadër të fondit të njëjtë, Fondi 22.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Formulari i Thesarit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në mbështetje të nenit 12.2, pika "d", nenit 40.2, pika "c" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 5 paragrafi 9 i Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.02/2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, si dhe në bazë të nenit 41.2, pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datë **6 shtator 2022** merr këtë:

**VENDIM
PËR SUBVENCIONIMIN E NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE
"PËRPARIMI"**

1. Me këtë vendim ofrohet përkrahje financiare për Ndërmarrjen Publike Lokale "Përparimi" në Vushtrri në vlerë financiare prej 90,000.00 €.
2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi do të merren nga kategoria subvencione dhe transfere, programi Infrastrukturë Publike (18184), nga të hyrat e bartura (fondi 22).
3. Qëllimi i subvencionimit të N.P.L. "Përparimi" është përkrahja financiare, për ngritjen e qëndrueshmërisë të kësaj ndërmarrjeje, si rezultat i krizës së madhe ekonomike dhe shkallës së lartë të inflacionit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
5. Ky vendim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit